

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Tëhuajtja / *el-Gurbeh* / الغُرْبَةُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"فَلَوْلَا كَانَ مِنَ الْقُرُونِ مِنْ قَبْلِكُمْ أُولُو بَقِيَّةٍ يَنْهَوْنَ عَنِ الْفُسَادِ فِي الْأَرْضِ إِلَّا قَلِيلًا
مِمَّنْ أَنْجَيْنَا مِنْهُمْ"

“Vetëm sikur të kishte ndër gjeneratat para jush persona të mençur, që ndalojnë të tjerët nga çrregullimi në tokë – përveç të paktëve nga mesi i tyre të cilët Ne i shpëtuam.”¹ (Hud, 116)

Tëhuajtja i referohet dallimit të personit prej bashkëkohësve. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është ndarja nga vendlindja. Për këtë të huaj:

- Vdekja është martirizim²
- Në varrin e tij, do të matet distanca mes vendlindjes së tij dhe varrit të tij³

¹ Ajeti flet për disa cilësi të të huajve: ata janë të pakët, të urtë (të mençur), dhe nuk janë vetëm të drejtë, por ndalojnë edhe nga e keqja.

² Kjo i referohet asaj që na ka ardhur në disa hadithe me vërtetësi të diskutueshme.

³ Kjo i referohet disa haditheve prej të cilëve më i sakti është hadithi ku Abdullah ibn Amr tregon: “Një burrë vdiq në Medine dhe kishte lindur aty. Pejgamberi ﷺ i fali namazin e xhenazes dhe tha: ‘Vetëm sikur të vdiste në një vend tjetër nga kjo vendlindje e tij!’ Njëri nga të pranishmit pyeti: ‘Përse, o i Dërguar i Allahut?’. Ai u përgjigj:

‘Kur një person vdes diku tjetër veç vendlindjes së tij, një hapësirë në xhenet i matet atij (aq sa distanca) nga vendi ku ka lindur deri në vendin ku ka vdekur.’ (E shënuan en-Nesa’i dhe Ibn Maxheh me një zinxhir të diskutueshëm, i cili u cilësua si i saktë nga disa të tjerë. Kjo mund të jetë një inkurajim për njerëzit që të kërkojnë atë që është mirë për ta në jetën e tyre dhe në jetën e përtejme, kudo që të jetë ajo.

- Dhe, në Ditën e Ringjalljes, ai do të bashkohet me Isën, birin e Merjemes⁴

Niveli i dytë është dallimi në gjendje (*haal*). Ky i huaj është prej atyre që u është premtuar bekimi. Ky është një person i drejtë në një kohë të prishur në mesin e njerëzve të prishur, ose një dijetar në mesin e të paditurve, ose një njeri i ndershëm në mesin e hipokritëve.

Niveli i tretë është dallimi në vendosmëri. Kjo është tëhuajtja në kërkim të të Vërtetit. Kjo është tëhuajtja e ‘arifit⁵, meqë ai është i pazakontë për sa u përket dëshmitarëve⁶ dhe bashkëkohësve të tij⁷. Gjetjet e tij nuk janë prurje të dijes,⁸ të zbuluara nga *wexhd*,⁹ të përcaktuara me formë,¹⁰ të shprehura me sinjale¹¹ dhe të përkufizuara me definicione.¹² Tëhuajtja e ‘arifit është mishërim i tërë tëhuajtjes, sepse ai është një i huaj në këtë jetë dhe në jetën e përtejme (ahiret)¹³.

⁴ Kjo i referohet një hadithi tjetër, që u cilësua si i vërtetë (*sahih*) nga dijetarët e Hadithit. Kjo meqë pesë të Dërguarve vullnetfortë, Isa عليه السلام pati më së paku ndjekës të afërt (nxënës).

⁵ ‘Arif (njohës) është ai, që i është dhuruar dija e dobishme e zemrës, jo thjesht vetëm dija teknike e intelektit.

⁶ Shenjat treguese të jashtme e të brendshme, që dëshmojnë për gjendjen e mirë të tij.

⁷ Dija, sjellje, dhe gjendja që e shoqërojnë atë në këtë botë, janë të ndryshme nga ato të të tjerëve.

⁸ Ndonëse ai nuk bie në kundërshtim me atë çfarë i dikton dija, vetëm dija nuk mund ta sigurojë atë.

⁹ *Wexhd* është një emër foljor, që vjen nga ‘*wexhede*’ (arab: gjeta ose përjetova). Kjo zakonisht përkthehet si ‘ekstazë’. Shih pjesën 66.

¹⁰ Ai është përtej asaj çfarë mund të mbajnë format materiale (të trupit).

¹¹ Këto s’mund të shpjegohen as nëpërmjet simbolikes.

¹² Asnjë e thënie s’mund ta përshkruajë.

¹³ Sepse kërkuesit e dynjasë nuk e njohin ose nuk anojnë nga ai, për shkak se ai dallon prej tyre; madje as shumica e kërkuesve të ahiretit nuk mund të identifikohen me gjendjen e tij.